



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Nr. 228 prot.

Tiranë, më 28. 01.2025

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 1031/8, DATË 30.07.2024 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT, TË NJË PJESË TË PRETENDIMEVE TË ANKESAVE, TË PARAQITURA NGA SHTETASIT Z. ARTUR SHKURTI DHE ZNJ. ALMA RUÇI”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga z. Artur Shkurti nr. 991 prot., datë 29.03.2023, nr. 991/2 prot., datë 06.04.2023, nr. 991/3 prot., datë 07.04.2023, nr. 991/6 prot., datë 03.05.2023, nr. 991/13 prot., datë 14.09.2023 dhe nga znj. Alma Ruçi nr. 991/10 prot., datë 06.09.2023, në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratëve H.B. me detyrë gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe E.R. me detyrë gjyqtar i Gjykatës Administrative të Apelit, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur dhe me vendimin nr. 1031/8 prot., datë 30.07.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas pas verifikimit, të një pjesë të pretendimeve të ankesave, të paraqitura nga shtetasit z. Artur Shkurti dhe znj. Alma Ruçi”, bazuar në nenin 122/4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Vlorë, sipas adresave të lëna nga ankuesit: Lagjja “I.Boletini”, Rruga “L. Malo”, Pallati Gëzim Xhemailit pranë Shkollës “Ismail Qemali”, Hyrja nr. 1, Kati 7, Vlorë dhe Lagjja “28 Nëntori”, Rruga “Kristo Negovani”, Vlorë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

